REPUBLIKA E SHQIFËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ÇËSHTJEVE JURIDIKE

SEKTORI I SEKRETARI-ARKIVIT

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

ues Prefekti i Qarkut Fier Nr.Prot 1269/1 Data 06.12.2024

rtimi i lëndës Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë të Këshillit

| | |
|---|---|
| rajtim nga: | së vendimeve nr. 70 dhe nr. 71, |
| ktura të tjera arkuara) | të Bashkisë Roskovec |
| orosi: | Z. Alw Hito, Z. Rla... |

☐ normal (7 ditë) ☐ Prioritet (3 ditë) ☐ Urgjent (Brenda ditës) ☐ Pa afat/ për dijeni/ Tjetër ___ ditë

10.12.2024 Nr.Prot Q374/1 Nënshkrimi: (TITULLARI) ________ 10.12.2024

ë në dorëzim: ___-___-___ Nënshkrimi ________

n për trajtim (struktura): ________-___-___

orosinë: ________

ë në dorëzim: ___-___-___ Nënshkrimi ________

n për trajtim (struktura): ________-___-___

orosinë: ________

ë në dorëzim: ___-___-___ Nënshkrimi ________

n për trajtim specialisti: ________-___-___

orosinë: ________

im i materialit përfunduar më: ___-___-___, Specialisti

im i materialit pranuar më: ___-___-___, Eprori në shkallë hierarkike

im i materialit miratuar më: ___-___-___, Eprori në shkallë hierarkike

im i materialit miratuar më: ___-___-___, Eprori në shkallë hierarkike

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**PREFEKTI I QARKUT FIER**
**SEKTORI JURIDIK**

Nr. 1268/1 Prot.    Fier, më 06.12.2024

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve Nr. 70, dhe Nr. 71, të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen e datës 25.11.2024.

**BASHKISË ROSKOVEC**

**KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC**

**Roskovec**

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 9237 prot. datë 27.11.2024, protokolluar pranë Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 1269 prot. datë 04.12.2024, bazuar në ligjin Nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut" (i ndryshuar) neni 4, pika 1, neni 8, shkronja "a", neni 16; Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 13, pika 2, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3, pika 2, shqyrtuam ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen e datës 25.11.2024, shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes Nr. 12, datë 25.11.2024, të mbajtur në Librin e Procesverbalit të Mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec me Nr. 8861, prot. datë 14.11.2024, si dhe dokumentacionin plotësues të vendimeve, shprehemi si më poshtë:

**Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 70, datë 25.11.2024, "Për miratimin e ndryshimeve në vendimin e këshillit bashkiak Nr. 109, datë 21.12.2023 'Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të bashkisë dhe të ndërmarjeve vartëse të bashkisë për vitin 2024', të ndryshuar"** shoqëruar nga projektvendimi Nr. 70, datë 20.11.2024, protokolluar me Nr. 9106 prot. datë 20.11.2024, dhe relacioni shpjegues Nr. 9106/1 prot. datë 20.11.2024, është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1/"b", neni 54, shkronja "dh"; Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 6, shkronja "d"; Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" (i ndryshuar); si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

**Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 71, datë 25.11.2024, "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025"** shoqëruar nga projektvendimi Nr. 71, datë 20.11.2024, protokolluar me

Nr. 9107 prot. datë 20.11.2024, relacioni shpjegues Nr. 9107/1 prot. datë 20.11.2024, dhe procesverbalet e konsultimit publik është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 8, pika 2, neni 9, pika 1/1.1/"b", pika 1/1.3/"b", neni 54, shkronja "f"; Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" (i ndryshuar) kreu III; Ligjin Nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 10081, datë 23.02.2009 "Për licencat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 8098, datë 23.03.1996 "Për statusin e të verbërit" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 7889, datë 14.12.1994 "Status i invalidit" (i ndryshuar); VKM Nr. 132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" (i ndryshuar) VKM Nr. 607, datë 29.7.2020, "Për tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" (i ndryshuar).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKTI**

**Arben Çuko**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI QARKUT FIER